



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E FINANCAVE

Drejtoria e Bashkerendimit te Luftes Kunder Pastrimit te Parave

Bul. "Deshmoret e Kombit", Tirane

tel: 355 42 290 49

Nr. 1049 Prot

Tirane, me 15.2 2002

UDHEZIM

Nr. 2, date 15.2 2002

PER

PROCEDURAT E IDENTIFIKIMIT, REGJISTRIMIT TE TE DHENAVE  
DHE RAPORTIMIT TEK "AUTORITETI PËRGJEGJES" PRANE  
MINISTRISE SE FINANCAVE

DISPOZITA TE PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky udhezim nxirret ne mbeshtetje te nenit 102, pika 4 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise dhe ne zbatim te Ligjit nr 8610, date 17.05.2000 "Per parandalimin e pastrimit te parave".

Neni 2

Subjekte të ketij udhezimi janë të gjitha ato qe përcaktohen ne nenin 3 të Ligjit nr.8610, date 17.05.2000.

Neni 3

Ky udhezim i sherben subjekteve që të hartojnë rregullore , udhezime si dhe te krijojnë kushte për identifikimin e klientëve përpara kryerjes së veprimit financiar, regjistrimit dhe raportimit të transaksioneve tek "Autoriteti Përgjegjes", me qëllim parandalimin e pastrimit të parave.

## PROCEDURAT E IDENTIFIKIMIT DHE REGJISTRIMIT

### Neni 4

Subjektet kryejnë procedurat e identifikimit sipas nenit 4, të ligjit nr. 8610, date 17.5.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave" dhe për çdo transaksion duhet të plotësohet "*Formulari i veprimeve në cash për shumat mbi 2 milion leke(ose kundra vleren në valutë)*".

### Neni 5

Te gjitha subjektet kanë të drejtë që për çdo transaksion që do të kryejnë të kërkojnë sqarime dhe të bejnë verifikime, përpara kryerjes së veprimit financiar mbi shumat e percaktuara në nenin 5 të Ligjit nr. 8610, date 17.05.2000 për të dale qarte burimi i krijimit të parave.

Subjektet identifikojnë klientet edhe në rastet kur ka të dhëna për pastrim të parave, megjithatë shumat e veprimit financiar mund të jete nën kufijtë e percaktuar në nenin 5 të Ligjit nr. 8610, date 17.05.2000.

### Neni 6

Identifikimi i klienteve nga subjektet realizohet nepermjet regjistrimit dhe mbajtjes, në dosje të vecanta, të të dhënave sipas nenit 4 të Ligjit 8610, date 17.05.2000:

- për personin fizik jo tregetar (individ);
- për personin fizik tregetar;
- për personin juridik;
- për përfaqësuesin ligjor të klientit.

Duke pasqyruar dhe të gjitha ndryshimet e bera deri në çastin e kryerjes së veprimit financiar.

### Neni 7

Dokumentacioni i identifikimit i të gjithë klienteve mbahet në origjinal dhe është i vlefshëm për një periudhë jo më pak se 5 vjet nga data e kryerjes së veprimit financiar.

### Neni 8

Te gjithë klientet, të cilët kërkojnë të kryejnë një veprim financiar mbi shumën e percaktuar në nenin 5 të Ligjit nr.8610, date 17.05.2000, deklarohen përfituesit

perfundimtar te fruteve te prones, burimin , natyren dhe te ardhurat e perfituara nga qarkullimi i parave duke plotësuar një deklaratë personale.

## PROCEDURAT E RAPORTIMIT

### Neni 9

Pas regjistrimit te veprimeve financiare, ne rast se ka elemente te dyshimit per pastrimin e parave , subjektet i raportojne “Autoritetit Pergjegjes” prane Ministrise se Financave me të gjitha format ( faks, email, telefon, korier etj.) jo me vone se 48 ore.

### Neni 10

Subjektet , i raportojne “Autoritetit Pergjegjes” per te gjitha veprimet financiare te klienteve mbi shumen 2 milion leke, ose kunder vleren ne monedha te tjera, ne rastet kur verejne :

- parregullsi ne veprimet financiare te klientit ;
- rrethana te nderlikuara , te pa zakonta dhe te pa justifikuara , ne veprimet financiare;
- veprimet financiare te klienteve nuk justifikohen nga pikepamja ekonomike dhe ligjore ;
- ka njoftime , se parate rrjedhin nga veprimtaria kriminale ;
- ka te dhena per pastrimin e parave .

Për keto plotesohet dhe raportohet “ *Formulari i sinjalizimit*” ,ku sqarohen elementet e dyshimit.

### Neni 11

Subjektet , i raportojne “Autoritetit Pergjegjes” per te gjitha rastet e veprimeve financiare ne cash dhe/ ose transfertave te fondeve per shuma mbi 70 milion leke ose kunder vleren ne monedha te tjera .

### Neni 12

Subjektet të emërojnë menjëherë personat përgjegjes , ku të gjithë punonjësit e tjere të raportojnë të dhena të mjaftueshme , për ndjekjen dhe zbatimin e ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave ”. Te dhenat për “Autoritetin Pergjegjes” jepen vetem nga personat përgjegjes të caktuar nga subjekti .

### Neni 13

Subjektet përgatisin dhe zbatojnë rregullore dhe udhezime të brendshme që t'ju sherbejnë punonjësve të tyre për të vlerësuar dhe identifikuar transaksionet e lidhura me veprimtari të paligjeshme.

### Neni 14

Subjektet marrin masa për informimin në mënyrë periodike të punonjësve për procedurat ligjore të vepres penale të pastrimit të parave si dhe për hartimin e programeve të trajnimit dhe kualifikimit të personelit të caktuar për këte qëllim.

### Neni 15

Subjektet janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin dhe ndalohen të njoftojnë klientin për procedurat e verifikimit për dyshimet për pastrimin e parave.

### Neni 16

Subjektet në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 8610, date 17.05.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave" kanë të drejtë të mos kryejnë transaksione financiare kur nuk sigurohen për identitetin e plotë të klientit, kur provon anonimatin e tij si dhe kur ka prova se transaksioni është i lidhur me pastrimin e parave.

## DISPOZITA TE FUNDIT

### Neni 17

Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhezimi ngarkohen "Autoriteti Përgjegjes" në Ministrinë e Financave si dhe të gjitha subjektet e përcaktuara në nenin 3 të Ligjit nr. 8610, date 17.05.2000.

Ky udhezim së bashku me formularet bashkëngjitur hyn në fuqi menjehere.

Anastas ANGJELI

MINISTER

**Formulari i veprimeve ne cash per shumat mbi 2 milion leke  
(ose kundervlera ne valute )**

<b>Pjesa I</b>		Identifikimi i personit fizik i cili kryen transaksionin me subjektin		tregeta <input type="checkbox"/>	jo treget <input type="checkbox"/>
1. Emri	2. Mbiemri	3. Adresa e perkohshme e banimit	4. Adresa e perhershme e banimit		
5. Data e lindjes					
6. Vendi i lindjes		8. Profesioni, pozicioni dhe biznesi		9. Nenshkrimi i personit	
7. Shtetesia					
10. Dokumenti i identifikimit: Pasaporte <input type="checkbox"/>		Leternjoftim <input type="checkbox"/>	13. Nr. i Vendimit Gjykates		
11. Nr. dokumentit		12. Leshuar nga	14. Nr. NIPT-it		
<b>Pjesa II</b>		Identifikimi i personit Juridik i cili kryen transaksionin me subjektin			
15. Emri i shoqerise, organizates, fondacionit, institucionit e te tjera te specifikuara					
16. Numri i kodit fiskal		17. Adresa e perkohshme e personit	18. Adresa e perhershme e personit juridik		
19. Numri i regjistrimit ne gjykate		juridik			
20. Data e regjistrimit ne gjykate / /					
21. Numri i identifikimit per personin e tatueshem per vleren e shtuar					
<b>Pjesa III</b>		Identifikimi i perfaqesuesit ligjor te klientit			
22. Emri	23. Mbiemri	24. Adresa e perkohshme e banimit	25. Adresa e perhershme e banimit		
26. Data e lindjes					
27. Vendi i lindjes		29. Profesioni, pozicioni dhe biznesi		30. Nenshkrimi i personit	
28. Shtetesia					
31. Dokumenti i identifikimit: Pasaporte <input type="checkbox"/>		Leternjoftim <input type="checkbox"/>	34. Prokura nr: _____		date
32. Numri		33. Leshuar nga	35. Leshuar nga _____		
<b>Pjesa IV</b>		Tipi dhe numri i llogarise qe preket nga transaksioni			
36	<input type="checkbox"/> Llogari rrjedhese .....	<input type="checkbox"/> Llogari e letrave me vlere .....			
	<input type="checkbox"/> Depozita pa afat .....	<input type="checkbox"/> Llogari kredie ... ..			
	<input type="checkbox"/> Depozita me afat .....	<input type="checkbox"/> Te tjera te specifikuara ....			
<b>Pjesa V</b>		Tipi i transaksionit. Sheno ne kutine perkatese.			
37. Lloji monedhes qe perdoret per te kryer transaksionet :		Leke	Usd	Euro	Te tjera
38. Kembim valute (monedhe per monedhe)					
39. Hyrje ne cash	<input type="checkbox"/> Depozite	<input type="checkbox"/> Blerje letrash	<input type="checkbox"/> Ceqe te blera	<input type="checkbox"/> Per transformim parash	<input type="checkbox"/> Te tjera te specifikuara
40. Dalje ne cash	<input type="checkbox"/> Thyerje ceqesh	<input type="checkbox"/> Blerje letrash me vlere	<input type="checkbox"/> Transferime	<input type="checkbox"/> Terheqje ne cash	<input type="checkbox"/> Te tjera te specifikuara
41. Shuma ne cash e transaksionit					
<input type="checkbox"/> Hyrje ne cash .....	<input type="checkbox"/> Dalje ne cash .....	<input type="checkbox"/> Data e transaksionit	<input type="checkbox"/> (shiko instruksionin)		
42. Qellimi i kryerjes se transaksionit		43. Burimi i te ardhurave			
<input type="checkbox"/> Blerje pasurie personale	<input type="checkbox"/> Sherbime personale	<input type="checkbox"/> Sherbime biznesi	<input type="checkbox"/> Shlyerje detyrimesh	<input type="checkbox"/> Kembim valutor	<input type="checkbox"/> Te tjera te specifikuara
<input type="checkbox"/> Shitje pasurie	<input type="checkbox"/> Nga biznesi	<input type="checkbox"/> Dhurata			
<input type="checkbox"/> Te tjera te specifikuara					
<b>Pjesa VI</b>					
Klienti perfutues i transaksionit					
44. Ky person eshte :	Shoqeri	<input type="checkbox"/> Fondacion	<input type="checkbox"/>		
a. Person juridik:	Organizate	<input type="checkbox"/> Te tjera ...	<input type="checkbox"/>		
	Institucion	<input type="checkbox"/>			
b. Person fizik:	Tregtar	<input type="checkbox"/> Jo tregtar	<input type="checkbox"/>		

45	Emri i personit fizik ose juridik			46. Adresa			
47	Nr. data e Vendimit Gjykates						
48	Nr. NIPT-it						
49	Numri i llogarise se personit fizik ose juridik ne favor te te cilit kryhet transaksioni						
50	Dokumenti identitetit per personin jo tregetar						
<b>Pjesa VII</b>	<b>Subjekti ku kryhet transaksioni</b>						
51	Emri i subjektit			52	Adresa e subjektit		
53	Nr. regjistrimit			54	tel. fax		
55	Emri i punonjesit qe pranon transaksionin						
56	Pozicioni			57	Nenshkrimi		
58	Personi i caktuar nga subjekti sipas ligjit 8610 "PPPP"						
59	Emri		60. Data		61	Nenshkrimi	

Ky formular dergohet tek "Autoriteti Pergjegjes" ne Ministrin e Financave brenda 48 oreve, per transaksionet e dyshimta mbi 2 milion leke dhe per te gjitha transaksionet mbi 70 milion leke.

Per cdo transaksion ploteso nje formular me te gjitha pjeset. Shiko instruksionin.

**INSTRUKSIONE**  
**MBI PLOTESIMIN E FORMULARIT TË VEPRIMEVE NË CASH**

**Instruksione të përgjithshme**

Cdo subjekt duhet të plotësojë këtë formular për çdo transaksion në cash për depozitim, terheqjen, këmbimin, pagesën apo transferen që ka një vlerë më të madhe se 2 milion leke ose kundërvlera në valutë të huaj. Në qoftë se një person fizik (individ), një person tregëtar, një person juridik apo një përfaqësues ligjor i klientit kryen brenda dites disa transaksione të cilat në vetvete janë në një vlerë më të vogël se 2 milion lekë ose ekuivalenti në monedhë të huaj, por në total kapin vlerën mbi 2 milion lekë ose ekuivalenti në monedhë të huaj, atëherë ky transaksion do të trajtohet si një i vetëm.

Kur personi plotëson formularin me të dhëna të pavërteta, atëherë ai mban përgjegjësi para ligjit sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë

**Instruksione specifike**

**Pjesa I**

Kjo pjesë do të plotësohet nga ana e personit, i cili kryen transaksionin në subjekt. Në të do të plotësohen të dhëna mbi identitetin e personit, i cili kryen transaksionin. Në qoftë se për llogari të një firme apo të një personi fizik kryhen disa transaksione nga persona të ndryshme, atëherë, në bazë të instruksionit të përgjithshëm do të plotësohen formularë për secilin veprim, por që të gjithë formularët do t'i bashkëlidhen formularit të parë që është plotësuar. Për shembull, në qoftë se personi A bën në datën 10.1.2002 një transaksion në emër të personit juridik X dhe disa orë më vonë personi B kryen një transaksion tjetër në emër të po këtij personi juridik X, atëherë dy formularët e plotësuar do të jenë të lidhur me njëri tjetrin.

Në pikat 1 dhe 2 do të shënohet emri dhe mbiemri i personit fizik që kryen transaksionin, Pikat 3 dhe 4 do të plotësohen me adresën e përkohëshme dhe të përhershme të personit, që kryen transaksionin.

Pika 7 do të plotësohet me të dhënat mbi profesionin, pozicionin në punë dhe emrin e personit juridik ku punon, si për shembull, ekonomist, financier, XY sh.p.k..

Në pikën 8, në qoftë se personi që kryen transaksionin në bankë është i huaj, atëherë është e nevojshme të shkruhet shteti në të cilin banon dhe në pikën 4 do të shënohet adresa e shtetit nga i cili ka ardhur.

Në pikën 10 do të shënohet lloji i dokumentit të identifikimit të përdorur nga personi. Në pikat 11 dhe 12 do të shënohen numri i dokumentit të identifikimit dhe autoriteti i cili ka lëshuar këtë dokument.

Në pikat 13 dhe 14, kur është person fizik tregëtar do të shënohet nr. i vendimit të gjykates dhe nr. i NIPT-it.

**Pjesa II**

Në këtë pjesë do të jepen të dhëna mbi identitetin e personit fizik ose juridik për llogari të të cilit kryhet transaksioni me subjektin.

Nëse në pjesën I-rë janë shënuar të dhëna mbi personin që bën transaksionin, në qoftë se ai këtë transaksion e bën jo si individ, por për llogari të një personi juridik, në pikën II

do të shënohen të dhëna mbi emrin e shoqërisë, të organizatës , të fondacionit e të tjera të specifikuar në emër të të cilit kryhet transaksioni .

Në pikën 16 do të shënohet numri i kodit fiskal, i cili është numri i certifikates së lëshuar nga zyra e tatim taksave.

Në pikën 17 do të shënohet adresa e përkohëshme e personit juridik , në qofte se ka , dhe në pikën 18 adresa e përhershme e tij. Në rast se është një person juridik i cili ka filiale në disa rrethe të vendit atehere do të shënohet adresa e filialit apo e shoqërisë mëmë, në varesi të vendit ku kryhet transaksioni. Për shembull, sh.p.k.X ka filial në Durrës dhe veprimi kryhet nga ky filial atehere , formulari do të plotësohet me adresen e filialit në Durrës.

Në pikën 21 do të shënohet numri i identifikimit për personin e tatueshëm për vlerën e shtuar të lëshuar nga zyra e tatim taksave(nr. i niptit)kjo pjesë sëbashku me pjesën e pare do të plotësohet nga klienti.

### **Pjesa III**

Kjo pjesë do të plotësohet në rast se veprimi kryhet nga personi që është përfaqësues ligjor i klientit .

### **Pjesa IV**

Pika 36 do të plotësohet duke vënë kryq në kutinë e llogarisë që preket dhe në vendin e shënuar me pika do të plotësohet nr. i llogarisë.

### **Pjesa V**

Pika 37 do të jape të dhëna mbi monedhen në të cilën fillohet ky transaksion në subjekt. Kështu, nëse do të behet një derdhje në euro do të vihet kryq pranë kësaj monedhe .

Në pikën 38 do të jepen të dhëna mbi këmbimin. Nëse është bërë këmbim nga një monedhë në një tjetër do të vendosen edhe monedhat përkatëse. Nëse do të kryhet edhe një transfertë tjetër atehere do të shënohet shuma në pikën 39 Hyrje në Cash dhe 40 dalje në Cash në monedhat përkatëse. Në rast se një pjesë e shumës depozitohet, atehere përveç sa më sipër do të shënohet me kryq pranë kutisë “Depozite”.

Në pikën 41 do të shënohet shuma me fjalë. Në pikën 42 do të shënohet qëllimi i kryerjes së transaksionit duke vene kryq në kutinë e specifikuar . Në pikën 43 do të plotësohet duke vene kryq sipas burimit të të ardhurave me të cilat behet transaksioni.

### **Pjesa VI**

Pikat 44 deri në pikën 50 do të plotësohen me të dhëna lidhur me personin juridik ose fizik tregëtar, në favor të të cilit kryhet transaksioni. Pika 44/a plotësohet kur është person juridik. Pika 44/b plotësohet për personin fizik tregëtar ose jo tregëtar. Kur është person fizik “jo tregëtar” plotësohen vetem pikat 45,46 dhe 50.

Kjo pjesë plotësohet nga klienti.

### **Pjesa VII**

Kjo pjesë do të plotësohet nga punonjësi i bankes që kryen transaksionin. Pikat 51,52,53 dhe 54 që përmbajnë të dhëna për bankën dhe për adresën e saj, të degës apo të agjensisë. Në pikat 55, 56 dhe 57 shënohen emri i punonjësit që pranon transaksionin , pozicioni i tij në degë apo agjensi dhe nënshkrimi i tij.

Në pikat 58,59 60 dhe 61 shënohen të dhënat për personin e caktuar nga subjekti sipas ligjit nr. 8610.date 17.05.2000.



Subjekti \_\_\_\_\_

KONFIDENCIALE

## FORMULARI I SINJALIZIMIT

Nr. \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_\_

### (A) SUBJEKTI TË CILIT I REFEROHET OPERACIONI

Emri i klientit \_\_\_\_\_

Adresa (vendbanimi ose selia ) \_\_\_\_\_

- e përkohëshme \_\_\_\_\_
- e përherëshme \_\_\_\_\_

Aktiviteti ekonomik \_\_\_\_\_

Kodi fiskal \_\_\_\_\_

Dokumenti eventual i identifikimit \_\_\_\_\_

### (B) PËRSHKRIMI I OPERACIONIT

- Lloji i transaksionit \_\_\_\_\_
- Shuma \_\_\_\_\_ me shifra dhe me fjalë \_\_\_\_\_
- Data \_\_\_\_\_

### (C) MOTIVI I DYSHIMIT

### (D) SUBJEKTET E LIDHURA

### (E) SHENIME EVENTUALE SHTESE

P.s .Ky formular dergohet te "Autoriteti Përgjegjës" në Ministrinë e Financave brenda 48 oreve se bashku me formularin e veprimeve në cash për veprimet mbi 2 milion lekë.